

Shtesat dhe ndryshimet që OSHEE sh.a. ka reflektuar në draft – kontratë janë si më poshtë:

Në vijim të gjeneraliteteve të palëve nënshkruese është shtuar:

Duke gene se:

- *Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 244, date 30.03.2016 "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike", në nenin 11 /2 përcakton: "Detyrimi i shërbimit publik për blerjen e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të energjisë i vendoset Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kontratën tip, të miratuar nga ERE".*

- *ERE me Vendimin nr.101, Date 23.06.2016 "Mbi miratimin e disa ndryshimeve në modelin e kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a. (FPPSH) dhe prodhuesve të vegjël të energjisë (PVE) miratuar me vendimin nr. 80 date 23.10.2009, të ndryshuar", ka miratuar disa ndryshime në modelin e Kontrates së shitblerjes së energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a (sot OSHEE sh.a) dhe Prodhuesve të vegjël të energjisë elektrike miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionereve nr.80 datw 23. 10.2009.*

- *ERE me vendimin Nr. 147, Date 30.09.2016 "Mbi miratimin e disa disa shtesave dhe ndryshimeve në modelin e kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike midis OSHEE dhe PPE të*

miratuar me vendimin e bordit të ere nr. 101, date 23.06.2016", ka miratuar disa ndryshime në

modelin e Kontrates së shitblerjes së energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a dhe Prodhuesve të vegjël të energjisë elektrike miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionereve nr.80 date 23.10.2009.

-*ERE me vendimin Nr.120, Date 27.07.2017 "Mbi përcaktimin e çmimeve të blerjes së energjisë*

elektrike të prodhuar nga burimet e vogla gjeneruese fotovoltaike me kapacitet të instaluar deri në

2 mw dhe eolike me kapacitet të instaluar deri në 3 mw", ka përcaktuar çmimin e blerjes së energjisë.

- *Shoqëria _____" sh.p.k dhe Ministria e Infrastrukturas dhe Energjisë kanë nënshkruar një kontratë "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit fotovoltaike" me kapacitet prodhues , në Bashkinë " me date ____ me Nr. rep., dhe Nr. kol.*

- *Në nenin 6 të kontratës "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit fotovoltaike me kapacitet prodhues KW, në Bashkinë, Qarku _____" është përcaktuar si detyrim i MIE "ti garantojë për 15 vjet blerjen e energjisë në zbatim të përcaktimeve të Ligjit Nr. 7/2017 "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme ", sipas cështjes së detyrimit të përcaktuar në pikën 1 të Vendimit të Entit Rregullator të Energjisë nr.120, dt.27.07.2017, i cili do të jetë i pandryshueshëm për këtë periudhë.*

Tek përkufizimi “Ligj”: është zëvendësuar ligji i vjetër i burimeve të rinovueshme me atë aktualisht në fuqi nr. 7/2017.

Në nenin 6, “Matja e Energjisë Elektrike të Livruar” është fshirë pika 6.1 me përmbajtje:

Palët në këtë kontratë do të sigurojnë njëra – tjetrën se livrimet dhe pranimi i energjisë elektrike do të maten ose verifikohen me sistem matje në përputhje me procedurat dhe

standartet e përcaktuara në Kodin e Funkcionimit të Shpërndarjes dhe Kodin e Matjes së Energjisë.

Është hequr gjithashtu pika 6.8 e nenit 6 me përmbajtje si vijon: *Në rastet kur përfaqësuesi i Blerësit nuk paraqitet në datën e caktuar, Shitësi do të kryejë procesin e faturimit konform rregullave në fuqi dhe do të dërgojë Blerësit faturën. Blerësi është i detyruar të shlyejë vlerën e faturuar. Çdo paqartësi për saktësinë e faturës nga ana e Blerësit, do të jetë objekt rishikimi dhe rregullimi në muajt e ardhshëm. Dhe në vend të saj është shtuar pika 6.7 (me numërimin e ri pas fshirjes së dy pikave sipërcituar)*

Shitësi do të kryejë procesin e faturimit konform rregullave në fuqi dhe do t'i dërgojë Blerësit faturën apo mundesoje atij leximin on-line me sisteme të aksesueshme nga te dyja Palet. Blerësi është i detyruar të shlyejë vlerën e faturuar. Çdo paqartësi për saktësinë e faturës nga ana e Blerësit, dote jetë objekt rishikimi dhe rregullimi në Muajt e ardhshëm”.

Në nenin 7, “Dokumentimi i Procesit të Livrimit/Pranimit dhe Matjes”, është përpunuar përmbajtja e pikës 7.1 si vijon:

7.1 Sipas një kërkesë të arsyeshme, Palët:

- a. do t'i sigurojnë njëra tjetrës dokumentacionin që disponojnë, I cili evidenton sasinë, livrimet dhe pranimet e Energjisë Elektrike për qëllimet e përcaktimit të masës dhe shkakut të çdo devijimi nga programet.*
- b. do të ndajne midis tyre çdo dokumentacion shtesë të nevojshëm për të verifikuar mosperputhjet mes flukseve të programuara dhe reale të energjisë elektrike.*

Nga përmbajtja e mëparshme e kësaj pike është hequr teksti: *“...do të sigurojnë njëra – tjetrës dokumentacionin që posedojnë, i cili evidenton sasinë, livrimet dhe pranimet e energjisë elektrike për qëllimet e përcaktimit të masës së shkakut të çdo devijimi nga programi”*

Në nenin 11 “Çmimi”, është shtuar pika 4 me përmbajtje: *“ERE përcakton dhe miraton me vendim brenda vitit aktual çmimin e shitjes së energjisë për vitin pasardhës. Nëse çmimi vjetor miratohet me vone së fillimi i vitit pasardhës, ky çmim do të jetë i zbatueshëm që nga data 01 Janar e vitit pasardhës dhe Palet do të bëjnë korrigjimet e nevojshme në faturat përkatëse për sasitë e levruara dhe të faturuara para miratimit të çmimit në përputhje me vendimin përkatës të ERE.”*

Në nenin 14 “Përfundimi i Kontratës”, është shtuar pika 9 me përmbajtje: *“Duke patur parasysh parashikimet e VKM-se Nr. 244 datë 30/03/2016 nëse kjo kontratë do të ndryshojë apo zgjidhet si njëdhjetë e një akti normativ të ERE apo të drejtat dhe detyrimet e saj do të transferohen në kuadër të zbatimit të legjislacionit në fuqi që rregullon Sektorin e Energjisë Elektrike dhe burimeve të Rinovueshme dhe jo nga vullneti i secilës pale, pala që mund të kërkojë zgjidhjen është e detyruar të njoftojë palen tjetër të pakten 30 (tridhjetë) ditë përpara ndryshimit, transferimit apo përfundimit të kontratës nëse në legjislacionin e ri nuk parashikohet ndryshe. Në një rast të tillë, Palet dote zbatojnë parashikimet e pikës (8) të këtij Neni për likuidimin e detyrimeve financiare midis tyre”*

Në nenin 15 “Afati i Kontratës” është hequr teksti: *“Kjo kontratë do të jetë në fuqi për një periudhë 15 (pesëmbëdhjetë) vjeçare. Për subjektet që kanë një kontratë të shitblerjes së energjisë elektrike me KESH sh.a para apo në kohën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, kontrata për shitblerjen e energjisë elektrike me OSHEE sh.a do të lidhet për periudhën e mbetur nga përfundimi i kontratës së lidhur me “ _____ sh.a” dhe është shtuar si në*

vijim:

“15.1 Kjo Kontrate do te jete ne fuqi per nje periudhe 15 (pesembedhete) vjeçare.

15.2 Afati i kontrates dote rishikohet ne perputhje me ndryshimet e akteve ligjore dhe nen ligjore.”

Në nenin 16, “Hyrja në Fuqi”, është hequr teksti: *“Kjo kontratë dispozitat e së cilës janë miratuar nga ERE hyn në fuqi pas nënshkrimit të saj nga palët.” dhe është riformuluar si në vijim:*

“16. 1. Kjo Kontrate do te filloje efektet e saj ne momentin e perfundimit te vepres dhe certifikimit te saj sipas kushteve te percaktuara ne kontraten e nenshkruar ndermjet Shoqerise " "dhe Ministrise se Infrastruktures dhe Energjise "Per ndertimin, shfrytezimin dhe administrimin e centralit fotovoltaiik " " me kapacitet prodhues --- KW, ne Bashkine , Qarku " si dhe kushteve te percaktuara ne Ligjin Nr.7/2017 "Per nxitjen e perdorimit te energjise nga burimet e rinovueshme" dhe akteve ligjore dhe nenligjore te dala ne funksion dhe mbeshtetje te ketij ligji si dhe me licensimin e Shoqerise " "nga Enti Rregullator i Energjise".

16.2 Kjo Kontrate dote miratohet ne Entin Rregullator te Energjise dhe do ti njoftohet Ministrise se Infrastruktures dhe Energjise.”

Në nenin 17 “Amendimi” është fshirë teksti: *“Në qoftë se ndonjë term, kusht apo rregull i kësaj kontrate do të bëhet i pavlefshëm, i paligjshëm apo i pazbatueshëm plotësisht apo deri në njëfarë mase, ky term, kusht apo rregull nuk do të sjellë pavlefshmërinë, paligjshmërinë apo pazbatueshmërinë e kushteve të termave dhe rregullave të parashikuara në pjesën tjetër të kësaj kontrate” dhe është riformuluar neni si më poshtë:*

Neni 17

Ndryshimet dhe Amendimet

“17 .1 Palet pranojne qe Ligji Nr.45/2015"Per Sektorin e Energjise Elektrike", Ligji 7 /2017 "Per nxitjen e perdorimit te energj ise nga burimet e rinovueshme", dhe aktet nenligjore te nxjerra ne funksion dhe mbeshtetje te tyre, te cilave i nenshtrohet kjo marreveshje per ndryshimet ne vazhdim dhe qe keto ndryshime mund qe nga ana e tyre te kerkojne qe amendimet te behen ne kete marreveshje.

17.2 Çdo ndryshim i kesaj kontrate miratohet me vendim te Bordit te ERE.

17.3 Çdo ndryshim ne aktet ligjore dhe nenligjore qe lidhen me zbatimin e kesaj marreveshje dote konsiderohet si nje ndryshim automatikisht ne kete kontrate”.